



Siguria dhe Punët e Brendshme

Janar 2022



POPULLIMI I ADRESARIT ME MBI 50 MIJË ADRESA TË SAKTA

Fushata sensibilizuese, "Adresa Ime", organizuar nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me pushtetin vendor, ka pasur efekt pozitiv në ndërgjegjësimin e qytetarëve për vetëdeklarimin e adresave. Në bazë të të dhënave të Gjendjes Civile deri sot janë saktësuar rreth 50,000 adresa të reja. Procesi kryhet online përmes aplikimit në e-Albania ose pranë zyrave të Gjendjes Civile kudo në vend. Aktualisht janë rreth 800 mijë familje që kanë një adresë të saktë sipas sistemit të unifikuar të adresave me tetë elementët përbërës.



NGRIHET QENDËR E PËRBASHKËT DOGANORE POLICORE ME GREQINË

Komisionet parlamentare miratuan p/ligjin për ratifikimin e marrëveshjes mes Shqipërisë e Greqisë, për ngritjen dhe funksionimin e një Qendre të përbashkët policore dhe doganore. Ajo do të rrisë bashkëpunimin kundër krimit ndërkufitar, krimit të organizuar, migracionit të paligjshëm, etj. Qendra, e cila do të ngrihet në Kakavije, nuk do të sjellë mbivendosje me organet doganore e policore, pasi do të ketë detyra të mirë-përcaktuara dhe të pavarura nga detyrat e organeve doganore dhe policore.



LISTA E ZGJEDHJEVE TË 6 MARSIT PUBLIKOHET BRENDA AFATEVE

Publikohet Lista Përfundimtare e Zgjedhësve, për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Lushnje, Rrogozhinë, të cilat do të mbahen në datë 6 mars 2022. Nga të dhënat e gjeneruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të drejtën e votës e kanë 654,538 shtetas shqiptarë me të drejtë vote. Nga ky numër i përgjithshëm, 10,134 zgjedhës votojnë për herë të parë. Ministria e Brendshme fton qytetarët të identifikojnë qendrën e votimit dhe i nxit të aplikojnë për mjet identifikimi, nëse u ka skaduar.



KONTROLL SATELITOR DHE ME DRONË, KUNDËR KULTIVIMIT TË KANABISIT

Gjatë një takimi me drejtuesit e lartë të Policisë së Shtetit, Ministri i Brendshëm Bledi Çuçi tha se gjatë vitit 2022, do të nisë kontrolli satelitor i territorit dhe përdorimi masivisht i droneve super-inteligjentë në luftën kundër kultivimit të kanabisit dhe fenomeneve të tjera kriminale. Ai theksoi se kushti i vetëm për sukses është zbatimit i ligjit pa asnjë luhatje apo kompromis, duke siguruar drejtuesit policorë se presioni politik mbi ta gjatë ushtrimit të detyrës është zero. Lufta kundër kultivimit të kanabisit vijon të jetë ndër prioritetet kryesore të MB.



OFICERË TË POLICISË SHQIPTARE DO TË TRAJNOHEN NGA XHANDARMËRIA TURKE

Ministri i Brendshëm Bledi Çuçi nënshkroi me homologun turk Süleyman Soylu, një marrëveshje për arsimimin policor. Sipas marrëveshjes, xhandarmëria turke do të vërë në dispozicion të Policisë së Shtetit gjithë ekspertizën dhe kapacitetet e veta. Në marrëveshje parashikohen trajnime me programe të avancuara që synojnë rritjen e përgatitjes profesionale të forcave tona të sigurisë dhe nxjerrjen e drejtuesve të

kualifikuar, që kanë njohuri dhe aftësi moderne. Një polici e përgatitur e ka më të lehtë t'u bëjë ballë sfidave të luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, krimit kibernetik etj.



ANALIZAT VJETORE – 50 MLN EURO TË SEKUESTRUARA NGA POLICIA NË 2021

Policia e Shtetit, përgjatë 2021, ka rritur me rreth 1% forcën zbuluese krahasuar me një vit më parë. Janë sekuestruar dhe konfiskuar rreth 50 milion euro (asete apo llogari bankare), nga veprimtari apo grupe kriminale. Të dhënat theksohen në analizat vjetore në 12 Drejtoritë Vendore të Policisë dhe ato të Kufirit&Migracionit. Në kuadër të luftës kundër korrupsionit, Policia ka evidentuar 41% vepra penale më

shumë. Shqetësim mbetet dhuna në familje, ku do të fokusohet në vijim puna parandaluese. Në analizën vjetore, mes qarqeve veçohet Berati, që në 2021 pati zero vrasje.